

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 636, DATË 26.10.2018 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË MËNYRËS SË SHKËMBIMIT DHE E PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT E TË DHËNAVE STATISTIKORE, TË KËRKUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS, PRANË STRUKTURAVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR"

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHET

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 636, datë 26.10.2018, përcakton llojin dhe mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

Propozimi për ndryshimin e këtij vendimi ka për qëllim:

- Ndryshimin e disa treguesve për të bërë të mundur mbledhjen e saktë dhe më të zgjeruar të informacionit që kërkohet për çështjet e të drejtave të fëmijëve.
- Vendosijen e disa treguesve të rinj, për të mbledhur më shumë informacion në kuadër të përmirësimit të politikave dhe programeve, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim hartohet në përputhje me programin qeverisës 2021-2025, Shtylla I "Rimëkëmbja e ekonomisë", pika 4, "Familja".

Projektvendimi është objektiv i përcaktuar në dokumentin strategjik të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, si edhe është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për katërmujorin e dytë të vitit 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Propozimet që bëhen për disa ndryshime të treguesve në këtë projektvendim, janë rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të dokumentit politik të mëparshëm, si edhe procesit të konsultimeve për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2021-2026.

Gjatë këtyre proceseve është parë e nevojshme ndryshimi dhe shtimi i disa treguesve, me qëllim mbledhjen më të saktë dhe më të gjerë lidhur me informacionin që kërkohet nga institucionet në nivel qendror dhe vendor.

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor".

Këto të dhëna do të shërbejnë për përmirësimin të politikave dhe programeve, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 44, të Ligjit nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka përputhshmëri me Acquis të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në projektvendim përcaktohet ndryshimi në Vendimin nr.636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

1. Shtojca I bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me Shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen strukturat përgjegjëse qendrore dhe vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe do të dërgohet për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Këshillin Konsultativ të Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare.

PROPOZUESI

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor".